

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Serbia hap fabrikën e dronëve izraelitë, Vuçiç: Do të furnizojmë edhe ushtri të tjera
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/serbia-hap-fabriken-e-droneve-izraelite-vucic-do-te-furnizojme-edhe-ushter-i586841
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 09:35:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 10:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	804245f2a6465defdc311f803537b714696268935679cda783a28c2313a455f3
TEKSTI	76b59c49ba8e3ad74135a179b37fd0219ec4ff8ebcfea3a9b4597f35a001d4e7
PAMJA	df16f55cf97ea1e7a5ae4597eae03d992fea333a8e1fb78729f01e622db5309

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a69418e40ac96ef7522aa49768d8c24bafda1769b54d0c7bd42c5569d2100f02
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a69418e40ac96ef7522aa49768d8c24bafda1769b54d0c7bd42c5569d2100f02>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 [English](#)



ie [Perfundon takimi i Rames me drejtuesit politike. Tokusi te dokumentet "Besa" dhe "Prania Besnike" Zgjedhjet parlamentare ne Rusi ne hyjen e lufte ne Ukraine, votime p](#)
fundit

Serbia hap fabrikën e dronëve izraelitë, Vuçiç: Do të furnizojmë edhe ushtri të tjera



18 Shtator 2026, 12:50Rajoni TEMA



Serbia ka hapur një fabrikë të re për montimin e dronëve të avancuar të projektuar në Izrael, të cilët do të përdoren nga ushtria serbe, por do të furnizojnë edhe forcat e armatosura të vendeve të tjera.

Lajmi u bë i ditur nga presidenti serb Aleksandar Vuçiç, i cili njoftoi të enjten, më 17 shtator, nisjen e aktivitetit të fabrikës së re.

Sipas Vuçiçit, në impiant do të montohen dronë izraelitë të teknologjisë së avancuar, ndërsa objekti pritet të punësojë rreth 100 persona.

Presidenti serb tha se prodhimi nuk do të jetë i destinuar vetëm për nevojat e forcave të armatosura të Serbisë. Dronët e montuar në vend do të synojnë gjithashtu tregun ndërkombëtar dhe furnizimin e ushtrive të vendeve të tjera.

Projekti nuk pritet të ndalet me këtë fabrikë. Vuçiç deklaroi se qeveria serbe dhe partnerët izraelitë presin të hapin të paktën edhe tre fabrika të tjera në territorin e Serbisë.

Detajet teknike të prodhimit janë mbajtur të kufizuara. Gazetarët nuk u lejuan të vizitonin fabrikën për shkak të konfidencialitetit të procesit të prodhimit, ndërsa Vuçiç publikoi vetëm disa pamje të objektit.

Hapja e fabrikës konkretizon një marrëveshje të paralajmëruar muaj më parë mes Serbisë dhe Izraelit. Në prill, Vuçiç kishte deklaruar se dy vendet synonin prodhimin e përbashkët të dronëve luftarakë, si pjesë e përpjekjeve të Beogradit për të forcuar kapacitetet e mbrojtjes dhe eksportet e industrisë ushtarake.

Serbia po investon prej vitesh në modernizimin e forcave të saj të armatosura dhe në zgjerimin e industrisë vendase të mbrojtjes, ndërsa bashkëpunimi me Izraelin i jep Beogradit akses në teknologji më të avancuar për dronët ushtarakë.

Fabrika e re shënon kështu kalimin nga planet për bashkëpunim në prodhim konkret, me Serbinë që synon jo vetëm të pajisë ushtrinë e saj, por edhe të zgjerojë praninë në tregun ndërkombëtar të pajisjeve ushtarake.

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

["Pse Vuçiç nuk është thirrur në Hagë?" Walker: I mërzitur e zhgënjyer nga BE, vendosi shenjën e barazimit me tmerret serbe](#)

Sali Berisha pranon se ka paguar para për të marrë një vizë amerikane, ja kush lloboi

10:30 Rajoni

Ali Ahmeti: Jam i indinjuar me Albin Kurtin, t'i lere pas zënkat me mua e Ramën

10:10 Rajoni

Ç'mund të ndodhë me shtatë figurat e UÇK-së që u përmendën në aktgjykimin e 16 shtatorit?

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.